



Planuar / Dorezuar Primjenol/Prudato Received/Delivery	30.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	5794/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.758/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr1068/2021 të datës 30.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A/02/187/2015 të datës 10.04.2015 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi [redacted] Komuna e Gjilanit, kundër Vendimit me numër protokoli 02-016-15016 të datës 30.03.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1.1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 30.09.2022 mori këtë:

### V E N D I M

- I. *Aprovohet pjesërisht si e bazuar* ankesa me numër A.02/187/2015 e datës 10.04.2015 e parashtruar nga ankuesja [redacted] e plotësuar dhe ndryshuar sipas parashtrësës me numër protokoli 5578/2022 të datës 21.09.2022.
- II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me numër protokoli 02-016-15016 i datës 30.03.2015 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit.
- III. *Obligohet Kryetari* i Komunës së Gjilanit që brenda afatit prej 15 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi të ndermerr veprimet e nevojshme administrative për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës së ankuesës nga 6 në 7 për periudhën nga dita e nxjerrjes së Vendimit Nr.02-046-15016 të datës 30.03.2015 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave deri në muajin mars 2016.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesja [REDACTED] e punësuar në Komunën e Gjilanit, më datë 10.04.2015 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1201/2015 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokollit 02-016-15016 të datës 30.03.2015 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave (tutje KZKA), me pretendimin ankimor së KZKA-ja ka tejkaluar kompetencën e tij. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën dhe t'i njohë të drejtën e kompensimit retroaktiv sipas Akt Emërimit të datës 02.10.2013.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit më datë 08.05.2015 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji i Këshillit, në ri shqyrtim ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.1068/2021 të datës 30.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Procesverbalin A.nr.1068/21 të datës 30.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Procesverbalin A.nr.1068/21 të datës 03.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Autorizimin lidhur me përfaqësimin në seancë gjyqësore të datës 03.08.2022; Ftesën lidhur me seancën gjyqësore të datës 03.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë drejtuar Këshillit; Fletë kthesën e datës 22.06.2022 lidhur me përgjigjen në padi; Përgjigjen në padi me numër të protokollit 3605/2022 të datës 21.06.2022 drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative; Aktvendimin me numër të protokollit 3108/2022 të datës 01.06.2022; Padinë me numër 6613 të parashtruar nga ankuesja në Gjykatën Themelore në Gjilan; Ankesën me numër të protokollit 1201/2015 të datës 10.04.2022 të drejtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e datës 09.02.2015; Vendimin me numër 02-016-15016 të datës 30.03.2015 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën e datës 26.12.2014 drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë; Përgjigjen me numër reference 06-343-143166-1 të datës 12.01.2015; Akt emërimit me numër protokollit 02-016-103220 të datës 02.10.2013; formularin e regjistrimit të ankesës; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1612/2015 të datës 08.05.2015; Akt emërimit me numër protokollit 16-20005 të datës 22.07.2011; Fletedorzimin me numër 02//016-15010/02 të datës 30.03.2015; Shkresën me numër 28 të datës 09.01.2015 lidhur me menaxhimin e punësimit dhe pagave mëditjeve për vitin 2015; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1303/2015 të datës 17.04.2015; Vendimin me numër të protokollit 1774/2015 të datës 21.05.2015; Procesverbalin e Kolegjit për Shqyrtimin e Ankesave të Këshillit të datës 21.05.2015; Emalin me numër të protokollit 5395/2022 të datës 14.09.2022 të drejtuar Këshillit; Emalin e datës 14.09.2022 të Këshillit drejtuar Akt emërimit me numër 02-016-48604 të datës 02.05.2019; Emalin me numër të protokollit 5405/2022 të datës 15.09.2022; Emalin e datës 14.09.2022 të drejtuar Këshillit; Emalin e datës 14.09.2022 të Këshillit drejtuar Listën e pagave për muajin 01.02.2016 deri me 26.02.2016, 01.03.2016 deri me 31.03.2016, 01.04.2016 deri me 30.04.2016; Emalin me numër të protokollit 5578/2022 të datës 21.09.2022 të F. Bunjaku drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Lidhur me plotësimin e ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.1068/2021 të datës 30.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka ri shqyrtuar çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si



dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankueses është pjesërisht e bazuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton së ankuesja sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 16-20005 të datës 22.07.2011 ishte emëruar *Zyrtare për Azhurnimin e Bazës Tekstuale Kadastrale*, me koeficient 6 të pagës, ndërsa më datë 02.10.2013 të njëjtës i është lëshuar Akt Emërimi me numër protokoll 02-016-103220 për pozitën e punës *Zyrtare për Azhurnimin e Bazës Tekstuale Kadastrale dhe Financiare*, me koeficient 7 të pagës.

Ankuesja me datë 26.12.2014 i është drejtuar me kërkesë Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës Gjilanit, lidhur me mos realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt Emërimit të datës 02.10.2013, ndërsa ky i fundit me datën 12.01.2015 në përgjigje të kërkesës së ankueses sqaron së pozita e ankueses *Zyrtare për Azhurnimin e Bazës Tekstuale Kadastrale* ka qenë më koeficient 6 të pagës dhe së buxheti i komunës është aprovuar konform koeficienteve të përcaktuar për vitin 2013, kështu që edhe në vitin 2014 kemi buxhet të njëjtë të aprovuar sikurse ne vitin 2013 rrjedhimisht ngritja e koeficienteve të pagës pa konfirmim të Departamentit për Buxhet dhe Financa e benë të pa mundur realizimin e ngritjes së koeficienteve.

Ankuesja me datë 09.02.2015 ka parashtruar ankesë në KZKA për rregullim të koeficientit të pagës sipas Akt Emërimit të datës 01.10.2013, ndërsa KZKA me Vendimin me numër protokoll 02-016-15016 të datës 30.03.2015 ka aprovuar ankesën e ankueses që ti bëhet rregullimi i koeficientit të pagës në pajtim me Akt Emërimin e datës 02.10.2013, duke mos njohur të drejtën e kompensimit në mënyrë retroaktive për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Ankuesja me bazë të njëjtë ankimore, parashtron ankesë më datë 10.04.2015 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, duke pretenduar së Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka tejkaluar kompetencat e tij dhe kërkon që t'i njehet kompensimi në mënyrë retroaktive i koeficientit të pagës nga data 01.10.2013.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës duke vendosur lidhur me ankesën e datës 10.04.2015, me Vendimin A.02/187/2015 të datës 21.05.2015 ka hedhur poshtë ankesën e ankueses me arsyetimin së e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Ankuesja ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.1068/2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses tani ankueses, duke anuluar Vendimin e Këshillit A.02/187/2015 të datës 21.05.2015 dhe lëndën e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Ankuesja me datë 21.09.2022 ka plotësuar ankesën e datës 10.04.2015 duke pretenduar që ti behët kompensimi i diferencës së koeficientit nga 6 në 7 nga data 01.10.2013 deri me 28.02.2016.

Kolegji i Këshilli duke marr për bazë rekomandimet sipas Aktgjykimit A.nr.1068/2021 të datës 30.08.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 82 paragrafin 2, ku është përcaktuar se: "...Vendimet e Komisioneve për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse", si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të





Ankesave gjegjësisht nenin 10 me të cilin parashihet se: "Institucioni përkatës është përgjegjës për zbatim të vendimit të Komisionit në pajtim me paragrafin 2 nenin 82 paragrafi të Ligjit" dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson së organi i punësimit në këtë rast Komuna e Gjilanit ka qenë e detyruar që të zbatoj Vendimin me numër protokolli Nr.02-016-15016/02 të datës 30.03.2015 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, duke bërë kompensimin e koeficientit të pagës së ankuesit sipas Akt-it të Emërimit të datës 02.10.2013. Ndërlidhur me këtë si dhe duke u bazuar në dëshmitë e përcjella nga organi i punësimit konstatohet se ankuesi koeficientin e pagës sipas Akt-it të Emërimit të datës 02.10.2013 e ka realizuar nga muaji mars 2016 dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton së Komuna e Gjilanit është e obliguar që ankueses ti kompensoj diferencën e koeficientit të pagës nga 6 në 7 lidhur me periudhën nga data e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 02-016-15016 të datës 30.03.2015 deri në muajin mars 2016.

Ndërsa, lidhur me pretendimin për realizimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 01.10.2013 deri në nxjerrjen e vendimit të KZKA-së, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesja nuk ka ndërmarr ndonjë veprim ligjor në kuptim të realizimit të koeficientit të pagës sipas Akti të Emërimit të datë 01.10.2013, deri me rastin e parashtrimit të ankesës në KZKA me datë 09.02.2015. Nisur ky konstatim, Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar në KZKA lidhur me pretendimin për kompensim e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga data 01.10.2013 është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: "...Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës" si dhe nenin 130 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative me të cilin përcaktohej se " Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi. 130.2. Në rastin e mosveprimit të administratës (mos nxjerrjes së aktit dhe heshtjes së plotë), ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ", andaj mbi këto arsye rezulton së janë pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të ankueses për kompensimin e pagës në mënyrë retroaktive.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02-016-15016/02 të datës 24.03.2015 ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe rrjedhimisht ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Ligjin Nr.2/L-28 për Procedurën Administrative.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndëse duke buzuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

*Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*



**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.758/2022**

**Ilire Mehmeti-Shaqiri**

*Procesmbajtëse*



**Ardita Haxhnikaj-Demi**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;
- Gjyqtarës Liridona Ajeti-Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.